



Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, (Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike), në University Institute of Lisbon (Instituto Universitário de Lisboa).

**Numri total i stafit për mësimdhënie: 2**

**Koha e kryerjes së mobilitetit: Semestri i dytë i vitit akademik 2022-2023, (brenda muajit maj)**

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës\*\*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching) për stafin akademik në universitetin pritës\*\*\*.

*\*Plani i mobilitetit, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*\*\*Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf akademik në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aproves, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj. Pikë kontakti: Joana Afonso, Coordenadora /Coordinator, joana.afonso@iscte-iul.pt*

*\*\*\* Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” ju lutemi klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) , aneks 4.

**Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 15 mars 2023, ora 12.00.**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)  
[rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al)



UNIVERSITETI POLITEKNIK I

**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

